

**Akt Themelimi**  
**i shoqërise me përgjegjësi të kufizuar "A.S.SHOES"**

Mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë , në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 , " Për shoqëritë tregtare" dhe në Ligjin Nr.9723 , datë 03.05.2007 "Për Q.K.R" dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqërite Tregtare , me vullnetin e tyre të lirë , të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi, sot më datë 13/08/2022 me ortakët :

**I. Antonio SPECCHIO me ID H13517001H**

krijojmë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "A.S.SHOES" me akt themelimi si vijon:

**Neni 1**

Formimi i shoqërisë

Formohet shoqëria tregtare private e quajtur "A.S.SHOES". Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit shqiptar , ndërsa degët që mund të krijohen do të nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues .

**Neni 2**

Selia e shoqërisë

- Selia e shoqërisë "A.S.SHOES" do të jetë: Vlore, Lagjja 24 Maji, Shkalla 1, Ap.9,Kati I 5 teknik, Pasuria Nr.18/50+1-9 ne ZK 8604. Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: [asshoes.albania@gmail.com](mailto:asshoes.albania@gmail.com).

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj , të hapë zyra përfaqësie , degë , të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë , vetëm me vendim të asamblesë së ortakëve.

**Neni 3**

Objektivi i veprimtarisë

Shoqëria do të zhvillojë veprimtaritë si vijojnë:

- Aktivitetet në fushën e fasonerisë: prerje, qepje, montim suprina kepucesh, kepuce të gjitha llojeve e formave, tregtim me pakice e shumice e tyre. Import-eksport materiale industrial të ndryshme, makineri e pajisje, lende të para et. Aktivitetet në fushën e tregtisë: tregti me shumice e pakice të materialeve të ndryshme të gjitha llojeve etj.

**Neni 4**

Kohëzgjatja e shoqërisë


Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar . Ajo mund shpërbehet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

**Neni 5**

Kapitali i shoqërisë

Kapitali fillestar i shoqërisë private "A.S.SHOES" do të jetë 100 (njqind ) Leke dhe është 1 kuote.

1. Ortaku themelues **Antonio SPECCHIO**: Zotërues i 1 kuote që përbëjnë 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë. (100 njqind lekë)



#### **Neni 6**

Drejtimi i shoqërisë

Shoqëria do të drejtohet nga administratori Znj. **Brisaida SEJDIRAJ**. Ai është përfaqësuesi i shoqërisë në marrëdhënie me të tretet dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj .

Cdo kontrate do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posacme .

#### **Neni 7**

Ortakët themelues kanë të drejte të emërojnë dhe administratorë të tjerë të vlerave materiale, kanë të drejtë të caktojnë financiarë dhe likuidatorë për problemet e shoqërisë.

#### **Neni 8**

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqiptar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë .

#### **Neni 9**

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme , me tekstin rreth saj .

#### **Neni 10**

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe vecanerisht të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Krijimin e Shoqërive Tregtare” , si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombetare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri .

#### **Neni 11**

Akti i themelimit u përpilua në 2 kopje , për t’ju shperndare organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë “**A.S.SHOES**”.

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortaku i vetëm.

Ortaku i “A.S.SHOES”

Antonio SPECCHIO

